



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA E PEJËS / MUNICIPALITY OF PEJA / OPŠTINA PEĆ

KUVENDI KOMUNAL PEJË

Komiteti për Politikë e Financa

I.Numër: 060/01-35441

Pejë, datë: 16 maj 2024

PROCESVERBAL

Nga takimi i - V- i Komitetit për Politikë e Financa i KK-së Pejë, mbajtur me **16 maj 2024**, në orën 10:00.

Takimi u mbajt në sallën e Komitetit për Politikë dhe Financa.

Pos anëtarëve të komitetit, në këtë takim prezantojnë: Kryesuesi z. Rexhep Kurtbogaj, Nënkyetar z.Fatmir Asllani, Drejtororeshë e DKRS-së, znj.Xhenet Syka, Udhëheqës i Sektorit për Çështje Pronore Juridike, z.Luan Gashi, Udhëheqës i Sektorit të Kuvendit, z. Avni Gashi zyrtare administrative, znj.Donjeta Morina, dhe përfaqësuesit e ZIP-it dhe OSBE.

Takimin e hapi dhe e udhëhoqi, kryesuesi z. Rexhep Kurtbogaj, i cili hapi diskutimin për rendin e ditës, dhe i sqaroi të gjitha pikat të cilat janë vendosur në rend ditë.

Pas diskutimeve nga të gjithë anëtarët prezent u miratua ky rend dite, me 9 vota pro, kundër nuk ka, të përmbajtur nuk ka.

Rendi i Ditës

1. Pjesëmarrja në takim e anëtarëve të komitetit dhe mungesa.
2. Shqyrtimi dhe miratimi i Procesverbalit të KPF-së dt. 16.04.2024.
3. Shqyrtimi dhe rekomandimi i Nismës për bashkëpunim Komunal Nërcombëtar në mes të Komunës së Pejës dhe Komunës së Ulqinit.
4. Shqyrtimi dhe rekomandimi i propozimit të DÇPJ dhe Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme Komunale me pronën private të Arton Kelmendi me qëllim të realizimit “Ndërtimi i Objektivit të Ri të Komunës” sipas Planit Rregullues Urban “Qendra-Pejë”, sipas Planit Zhvillimor Komunal.
5. Shqyrtimi dhe rekomandimi për propozim - shfuqizimin e Vendimit nr. 03/2024 me nr.protokolli 400-01/11637 datë 27 shkurt 2024 K.K. Pejë, mbi miratimin e propozimit të Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme Komunale me pronën private të Avdyl Çetaj me qëllim të realizimit të shtegut të ecjes buzë Lumit “Lumbardhë” dhe ndërtimit të rrugës “Maja Zezë” sipas PZHK.
6. Shqyrtimi dhe rekomandimi i propozimit të DÇPJ dhe Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme Komunale me pronën private të Avdyl Çetaj me qëllim të realizimit të shtegut të ecjes buzë Lumit “Lumbardhë” dhe ndërtimit të rrugës “Maja Zezë” sipas PZHK.
7. Shqyrtimi dhe rekomandimi i propozimit të DÇPJ dhe Kryetarit të Komunës për miratimin paraprak të draft - vendimit për dhënie në shfrytëzim afat shkurtër të pronës së paluajtshme Komunale në objekt të Komunës – dy (sportele) për aktivitete bankare.
8. Shqyrtimi dhe rekomandimi i propozimit të DÇPJ dhe Kryetarit të Komunës për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim afat shkurtër të pronës së paluajtshme Komunale në objekt të Komunës – dy (sportele) për aktivitete bankare.
9. Shqyrtimi dhe rekomandimi i propozimit të DÇPJ dhe Kryetarit të Komunës për formimin e komisionit të ankesave të palëve në procedurën e dhënies në shfrytëzim afat shkurtër dhe afatgjatë të pronës së paluajtshme Komunale.
10. Shqyrtimi dhe rekomandimi i propozimeve të komisionit për tituj nderi, dekorata, mirënjohje dhe falënderime për vitin 2024.
11. Pytjet dhe propozimet lidhur me punën e Komunës, të ngritura nga anëtarët, në atë rënditje siç jan pranuar:

1.Pjesëmarrja në takim e anëtarëve të komitetit dhe mungesa.

Nuk ka pasur.

2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të KPF-së dt. 16.04.2024

Unanimishtë nga të gjithë anëtarët prezent, miratohet procesverbali i KPF-së i dt.16.04.2024.

3.Shqyrtimi dhe rekomandimi i Nismës për bashkëpunim Komunal Nërcombëtar në mes të Komunës së Pejës dhe Komunës së Ulqinit.

Znj.Xhenet Syka Kelmendi: me kërkesen e kryetarit të Komunës së Ulqinit z.Omer Bajraktari, ne e kemi sjellë në rend dite që të aprovoni! njëhere ju para se te prezentojmë te takimi i rregulltë bashkëpunimin në mes të Komunës së Pejës me Komunen e Ulqinit. Në takimin e Ballkanit

përendimor muajin e kaluar kanë marr pjesë të dy nënkryetarët në Ulqin, meqë rast e kemi pranuar edhe një ftesë për binjakzimin të Komunës së Pejës me Komunën e Ulqinit. Duke pasur parasysh edhe historinë e gjatë që ka komuna e Pejës me atë të Ulqinit fillimisht në lidhjet familjare dhe me pastaj me historikun e egsodit të vitit 1998-1999. Por që nisma do të begatohet dhe me teper me një diplomaci kultërore dhe turistike, bazamenti i kësaj diplomacie do të qendroj përderisa Ulqini do të ofroj resurset bregtetare, ne do të mundohemi të iu ofrojmë resurset malore në veqanti atë të turizmit malor. Meqenëse me 16 qeshor e kemi festen kemi marr iniciativen që fillimisht z.Omer Bajraktari dhe ekipi i tij të ftojme në Pejë edhe të marrin pjesë në festen tonë, edhe të radifikojmë memorandumin e bashkëpunimit për binjakëzimin e Komunës së Pejës me Komunen e Ulqinit.

Z.Berat Ganiqi: vetem po më interson a është iniciativ e re apo ka rrjedh më heret?

Znj.Xhenet Syka Kelmendi: në fakt është biseduar disa herë, por asnjëher nuk është nxjerr një memorandum të këtij bashkëpunimi. Që nga viti 2016 kur Komuna e Deçanit është binjakëzuar ka pasur iniciativa, mirëpo si duket i ka ardhur fundi sa i përket ratifikimit.

Z.Berat Ganiqi: në rregullë vetëm po më intereson a është si rrjedhojë e nënshkrimit të dokumentit me komunën e Bujanovcit me Ulqinin në vitin 2020 që e keni pas?

Znj.Xhenet Syka Kelmendi: jo ajo ka të bëj me Unionin e Bashkësive Shqiptare në rajon, dhe nënkupton një iniciativ komplet tjetër.

Unanimishtë nga të gjithë anëtarët i rekomandohet kuvendit, Nisma për bashkëpunim Komunal Nërkkombëtar në mes të Komunës së Pejës dhe Komunës së Ulqinit

4.Shqyrtimi dhe rekomandimi i propozimit të DÇPJ dhe Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtëshme Komunale me pronën private të Arton Kelmendi me qëllim të realizimit “Ndërtimi i Objektivit të Ri të Komunës” sipas Planit Rregullues Urban “Qendra-Pejë”, sipas Planit Zhvillimor Komunal.

Nënkryetari Fatmir Asllani:është në bazë të planit rregullues me u liru hapsirat që janë në oborr të komunës, mendojmë me e zgjeru objektin e komunes. Ideja është që të gjitha drejtorit që janë të shpërndara në objekte me i mbledh të gjitha në një vend, dhe me funksionu komuna në një objekt. Por tash sa kemi me mujt me realizu është rrugë e gjatë, mirëpo duhet me u nis kjo punë.

Z. Berat Ganiqi: sa po e shoh unë po jepet kjo pjesa poshtë këtu në mes të drejtorisë gjeodezi dhe kadater dhe kuvendit komunal, problemi është se a e keni kqyr mirë këtë pjesë mos po ju vyn diçka për më vonë? Por as ky nuk po shoh që ka zgjidhje me ndërtu diçka këtu në mes të kësaj ndërtese!

Nga të gjithë anëtarët prezent me 5 votë pro, 2 votë kundër, 2 votë të përmbajtur, i rekomandohet kuvendit për shqyrtim propozimi i DÇPJ dhe Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtëshme Komunale me pronën private të Arton Kelmendi me qëllim të realizimit “Ndërtimi i Objektivit të Ri të Komunës” sipas Planit Rregullues Urban “Qendra-Pejë”, sipas Planit Zhvillimor Komunal.

5.Shqyrtimi dhe rekomandimi për propozim - shfuqizimin e Vendimit nr. 03/2024 me nr.protokolli 400-01/11637 datë 27 shkurt 2024 K.K. Pejë, mbi miratimin e propozimit të Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme Komunale me pronën private të Avdyl Çetaj me qëllim të realizimit të shtegut të ecjes buzë Lumit “Lumbardhë” dhe ndërtimit të rrugës ‘Maja Zezë’ sipas PZHK.

Z.Luan Gashi: te shfuqizimi ka ardh për shkak se MAPL-ja vendimin e ligjëshmërisë e ka sjellë që së pari të bëhet vlerësimi i pronave. Më heret na i kryejshim pa vlerësim pastaj i dërgojshim në vlerësim por tash e kanë ndryshu, pastaj ne i kemi ndjek pikat që i ka rekomandu MAPL-ja njëhere e kemi propozu shfuqizimin e vendimit, pastaj e kemi bo propozimin me vlerësim financiar e me të gjitha pastaj e kemi parashtru.

Nënkryetari Fatmir Asllani: vetem sa për plotësim ka shku me të vjetres siq i kemi dërgu çdo here propozimet për kuvend, tani është hy në fuqi rregullorja e re e cila duhet një here me u vlerësu prona pastaj me shku në kuvend. Tani është kry edhe paravlerësimi, dhe pika e 6 për të njëjten temë bëhet fjalë.

Z.Labinot Panxha: ne shumë here kemi bër vërjetjet tona në lidhje me këmbimet që janë bër të pronave komunale, që po janë disa raste që MAPL-ja po i kthen prapa vendimet, si jo në përputhje me ligjin. Ju thatë rregulloret e reja por Ligji për dhënjen në shfrytëzim për pronen e paluajtshme të komunes e përcakton qartë, që fillimishtë duhet me të bëhet vlerësimi. Pra nuk është diçka e re ligji e përcakton ashtu, dhe ne si subjekt i kemi dhënë vërejtjet tona. Po ashtu e kam friken se nëse vazhdojnë me këmbimin e pronave se si kanë shku atëhere, ne nuk kemi me bo kurgjo veq kemi me mar vendime dhe pastaj MAPL-ja me ti kthy për me i shfuqiziu dhe pastaj me na shku mandati fuqizo dhe shfuqizo vendime. Për këtë arsye nuk jemi kundër zhvillimit të qytetit por jemi kundër këmbimeve që vin në kundërshtim me ligjin, dhe nëse kishin ardh në përputhje me ligjin po besoj që asnjëri prej neve ktu kish hezitu me votu pro. Sepse ne e dim që cdo punë e mirë në qytet shkon në tëmirë të qytetarëve. Për mos me marr fjalen edhe për pika të tjera ne si subjekt politikë nuk i votojmë këto këmbime, sepse mendojmë që janë në kundërshtim me ligjin për dhënje në shfrytëzim dhe këmbim të pronave të paluajtshme të komunës.

Nga të gjithë anëtarët prezent me 5 votë pro, 4 anëtar nuk kanë mar pjesë në votim, i rekomandohet kuvendit propozim - shfuqizimin e Vendimit nr. 03/2024 me nr.protokolli 400-01/11637 datë 27 shkurt 2024 K.K. Pejë, mbi miratimin e propozimit të Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme Komunale me pronën private të Avdyl Çetaj me qëllim të realizimit të shtegut të ecjes buzë Lumit “Lumbardhë” dhe ndërtimit të rrugës ‘Maja Zezë’ sipas PZHK.

6.Shqyrtimi dhe rekomandimi i propozimit të DÇPJ dhe Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme Komunale me pronën private të Avdyl Çetaj me qëllim të realizimit të shtegut të ecjes buzë Lumit”Lumbardhë” dhe ndërtimit të rrugës ‘Maja Zezë’ sipas PZHK.

Kryesusi Rexhep Kurtbogaj: bëhet fjalë për pikën e njejt që është shfuqizu për shkak se MAPL-ja ka formu rregulloore të re dhe kjo pikë ka mbet në procedurë të vjetër, dhe kanë rekomandu me ju përshtat rregullores së re.

Z.Berat Ganiqi:me rregullore e re shihet fare mirëedhe pse ligji e ka parapa edhe në atë tjetrën, se njëhere është dasht me u bo vlersimi financiar, është dasht me shiku a ka ndonjë problem gjygjësor, të cilat asnjë nga këto këmbime që janë bo nuk ka pas asnjë kontestë gjygjësor as prej Gjykates Themelore në Pejë dhe as prej ndonjë institucioni tjetër që nuk zhvillohet ndonjë procedurë gjygjësore për këto konteste. Po ashtu edhe te vlerësimi shihet se prona me të cilen po këmbehet e z.Avdyl Çetaj i ka në posedim 257m2 që vlere e tyre në total është 115,650.00 euro. Duke marr parasysht e ka edhe ni ngastet kadastrale me 543m2 edhe kjo në total ka vleren e 27,150.00 euro, me këmbi me pronen që po i jep komuna e Pejës me 1417m3 që në total vlere e saj është 255,060.00 euro. Çka ka me ndodhë tash këtu a ka me ia jep ky komunës Pejës për afërsisht 112.000.00 euro më shumë apo çka ka me ndodhë? Kjo është që na gjatë gjithë kohes e kemi ngrit shqetësimin si opozitë, kemi qenë të ashper në punen e këmbimit dhe kjo është një ekspertizë financiare të ekspertëve. Nuk e kemi bo as ju as na, por disa ekspert që thirren financiar dhe po shihet një disbalanc i madhë financiar. Për këto këmbime të tilla duke e marr parasysht se qysh bëhen kemi me qenë kundër, duke marr parasysht edhe faktin që nuk juaanë pronë kadastrale që e obligon ligji me qenë në kufi kadastral me pronen e këmbime dhe janë krejt tjetër kah! Andaj për neve janë shkelje të tjera të një pas njëshme që janë duke ndodhur në këtë lloj të këmbimit të pronave. Ashtu siq e kemi ngrit shqetësimin që po dalin që duhet me u shfuqizu vendimet, prap po ngrisë shqetësimin që këto këmbime nuk janë në rregullë ligjërishhtë.

Kryesusi Rexhep Kurtbogaj: vet fakti që i nënshtrohet vlerësimi i ligjëshmërisë të bën me kuptu që ne nuk jemi duke dashur të ikim jashtë formave ligjore, në momentin që kthehet nga ministria atëhere edhe për neve është me u kthy mbrapa, dmth është e plotëfuqishme dhe jemi duke u përmbajt bazuar në procedura ligjore.

Z.Berat Ganiqi: drejtori i ÇPJ-së ka thonë ktu që vlere e arit të tokë te Maja e Zezë është 1500 euro, ktu po na del pak ma ndryshe vlerësimi financiar ari 255mijë euro!

Nga të gjithë anëtarët prezent,t me 5 votë pro 4 anëtar nuk kanë marr pjesë në votim, i rekomandohet kuvendit për shqyrtim propozimi i DÇPJ dhe Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme Komunale me pronën private të Avdyl Çetaj me qëllim të realizimit të shtegut të ecjes buzë Lumit''Lumbardhë''dhe ndërtimit të rrugës ''Maja Zezë''sipas PZHK.

7.Shqyrtimi dhe rekomandimi i propozimit të DÇPJ dhe Kryetarit të Komunës për miratimin paraprak të draft - vendimit për dhënie në shfrytëzim afat shkurtër të pronës së paluajtshme Komunale në objekt të Komunës – dy (sportele) për aktivitete bankare.

Nënkryetari Fatmir Asllani: një sqarim të shkurt këto i kemi dhënë më heret përmes zyres së prokurimit por tash me keo ndryshime që janë bo në ligj nuk mundet me shku përmes komisione janë dy banaka të vogla të cilat janë për shërbim të qytetarëve. Është afëru me skadu kontrata dhe është në proces me dhën edhe njëhere del në ankand kjo punë, dhe aty dihen rregullat qysh shkojnë.

Z.Luan Gashi: ankandi është hapur, bëhet komisioni vlerësues dhe komisioni për ankesa, siq janë dhën parkingjet ipen edhe këto!

Kryesusi Rexhep Kurtbogaj: pika e 7 është për miratim për dhënjën në shfrytëzim, ndërsa pika e 8 edhe 9 janë për komisionet.

Nga të gjithë anëtarët prezent me 5 votë pro, 4 votë të përmbajtur, i rekomandohet kuvendit për shqyrtim paraprak të draft - vendimit për dhënie në shfrytëzim afat shkurtër të pronës së paluajtshme Komunale në objekt të Komunës – dy (sportele) për aktivitete bankare.

8.Shqyrtimi dhe rekomandimi i propozimit të DÇPJ dhe Kryetarit të Komunës për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim afat shkurtër të pronës së paluajtshme Komunale në objekt të Komunës – dy (sportele) për aktivitete bankare.

Kryesusi Rexhep Kurtbogaj: në komision duhet të marrin pjesë dy anëtar të kuvendit, dy anëtar nga ekzekutivi dhe një anëtar nga shoqëria civile, emrat e anëtarëve propozohen në seancën e kuvendit.

Nga të gjithë anëtarët prezent me 5 votë pro, 4 anëtar nuk kanë marrë pjesë në votim, i rekomandohet kuvendit për shqyrtim formimimi e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim afat shkurtër të pronës së paluajtshme Komunale në objekt të Komunës – dy (sportele) për aktivitete bankare.

9.Shqyrtimi dhe rekomandimi i propozimit të DÇPJ dhe Kryetarit të Komunës për formimin e komisionit të ankesave të palëve në procedurën e dhënies në shfrytëzim afat shkurtër dhe afatgjatë të pronës së paluajtshme Komunale.

Kryesusi Rexhep Kurtbogaj: komisioni i ankesave ka mandat 2 vjeçar dhe njejt sikur përbërj e komisionit të vlerësimit dy anëtar të kuvendit, dy anëtar nga ekzekutivi dhe një anëtar nga shoqëria civile.

Nga të gjithë anëtarët prezent me 9 votë pro, i rekomandohet kuvendit për shqyrtim formimimi komisionit të ankesave të palëve në procedurën e dhënies në shfrytëzim afatshkurtër dhe afatgjatë të pronës së paluajtshme Komunale.

10.Shqyrtimi dhe rekomandimi i propozimeve të komisionit për tituj nderi, dekorata, mirënjohje dhe falënderime për vitin 2024.

Kryesusi Rexhep Kurtbogaj: procedurën e dhënjes së autorizimit dhe formimin e komisionit e kemi kryer, ndërsa komisioni ka punuar në kërkesat që kanë ardhur për propozimet për personali të ndryshme për tituj nderi, dekorata, dhe mirënjohje. E kemi drejtoreshen prezent e cila është edhe kryesuse e grupit.

Znj.Xhenet Syka Kelmendi:po ju them me përgjegjësi të plotë se komisioni e ka mbaruar punën për çfarë është emruar në kuvend. Përkritazi nga takimi i parë dhe i fundit në kuvend ne kemi

nxjerr edhe procesverbal. Procesverbali është përcjellur tek kuvendi dhe si i kompletuar do të përcjelllet edhe tek ju. Garantoj që kemi pasur korum për qfare kemi edhe fakte dhe të gjitha propozimet që janë paraqitur tek dosja e vitit 2024 sa i përket titujve të nderit, mirënjohjeve, dekoratave janë shqyrtuar nga komisioni veq e veq. Siq e dini roli i komisionit është të shqyrtoj dokumentacionin përkatës, para se ai dokumentacion të niset në kuvend. Ndërsa roli tjetër është të kuptoj se a është dokumentacioni i kompletuar. Pas gjithë punës që është bërë përmes takimeve ne i kemi paraqitur dosjet veq e veq karshi titujve për çfarë janë propozuar. Duke filluar nga propozimet që kanë ardhur nga kabineti i kryetarit, asociacione civile, qytetarë të shumë të, organizata joqeveritare, dhe të gjitha bashke i kemi të bashkëngjitura tek procesverbali i takimit.

Z.Labinot Panxha: e mora fjalën më shumë për respekt të subjektit tim që më ka propozu në këtë komision dhe të kuvendit në përgjithësi. Konsideroj që është e nevojshme me dhënë një sqarim, në lidhje me organizmin e këtij komisioni. Fillimisht unë në (viber) jam shtu në atë grup dhe pas dy jave ka ardhur një mesazh nga anëtarët i këtij komisioni Atdhe Berisha, ku ka propozu mbajtjen e takimit. Unë, i kam propozu gjithëashtu në cilësinë e anëtarit të këtij komisioni që data e nesërme të shtyhet për javën e ardhshme, për arsye se unë nuk gjindem në Kosovë. Megjithatë e kanë mbajtur takimin përkundrazi propozimit tim për me u shty dhe me u mbajtur javën e ardhshme. Pasi që është mbajtur takimi në procesverbal e kam pa aty, kanë thënë që kam mungu mirëpo nuk i kanë cekur arsyet ose propozimin tim. Pastaj e kemi marrë edhe një njoftim në cilësinë e kryesutit është paraqitur antari i grupit nga radhët e LDK-së z.Atdhe Berisha, ka kërkuar të mbahet takimi në datën të cilën ai e ka propozu. Unë, kam dhënë vrejete me mënyrën e njoftimit dhe të kordinimit, gjithashtu kam kërkuar që meqenëse ne jemi anëtarët e kuvendit, jemi caktuar si komisioni kam propozu që ky komision të mblidhet në sallën e kuvendit. Sepse nuk është e nevojshme që ne të shkojmë nëpër zyre të drejtorive, jemi anëtar të kuvendit dhe puna jonë është këtu në kuvend. As kjo nuk është marrë parasysh, dhe duke e marrë parasysh që kërkesat dhe propozimet e mia nuk janë miratuar, nuk janë marrë në konsideratë unë e kam pas të pamundur me marrë pjesë nëpër takime. Disa emra i kam dëgjuar prej kolegëve që janë propozuar at dhe kam respekt për ata emra, ndihem keq që nuk kam mundur me marrë pjesë. Në lidhje me këtë dikush duhet me dhënë llogari të paktën morale se çka e kish penguar Labinotin në atë komision, dhe çka ish kone pamundur me ndodhë nëse e kishim mbajtur takimin në sallën e kuvendit. Vlen me theksu se rregullorja e thotë qartë që një titull nderi jepet një personitet, dhe nuk i jepet shumë personitetëve i njëjti titull dhe këtu shpresoj që nuk e kanë bërë gabimin komisioni!

Z.Berat Ganiqi: unë e kom problemi tek mënyra se si na organizohemi, megjithatë respektin drejtoreshë a bën me ditë se cila organizatë e shoqërisë civile e ka propozuar anëtarin shoqërisë civile z.Granit Vllata, e ki mik dhe e kam mik nuk kam kurgjo kundë tij por të paktën prej ciles shoqëri civile rrjedhë ai emer?

Znj. Xhenet Syka Kelmendi: e di që jeni shumë koshiencë me i përcjellë ngjarjet e komunës, por e kuptoj edhe kur përvjedhet ndonjë informacion mirëpo ju garantoj me përgjegjësi të plotë se ekzistojnë faktet. Kryesia e kuvendit dhe kryesusi kanë ftuar në takim të organizatave të shoqërisë civile në takim të hapur, të cilët kanë pas të drejtë të propozojnë dhe ta votojnë kandidatin e tyre. Ftesa dhe takimi kanë qenë të hapura nuk po më kujtohet data, mirëpo është mbajtur në sallën e kuvendit komunal dhe ka pasur shoqëri civile. Kanë qenë të propozuar dy kandidatë por kundër kandidatja e Granitit nuk e fitoj garenë, për arsye se vinte nga komuna e Klina dhe rregullorja e përcakton që anëtarët e komisionit nga shoqëria civile duhet të jenë nga organizata joqeveritare që veprojnë në kufi administrativë të komunës së Pejës. Ndërsa sa i përket çështjes tjetër nuk po

e shoh ndonjë moment për me u përgjegj, i kam dy elemente e para është shumë e vërtet kryesues i komisionit është z.Atdhe Berisha i zgjedhur nga kuvendi komunal, egziston protokoli dhe procesverbali kur janë zgjedhur anëtarët e këtij komisioni; kryesus është zgjedhur z.Atdhe Berisha nga LDK. Në këtë rast kryesusi e ka për detyrë të ftoj në takime dhe ti menaxhoj ato, ndërsa sa i perket hapsirave të drejtoratit për kulturë, rini, dhe sport është e vërtet që aty jam drejtoreshë, por tradicionalisht është viti i 10-të që ky komision takohet takohet te DKRS-së, për të vetmën arsye se i njëjti kuvend e voton drejtorinë për kulturë, rini, dhe sport si organ që e fasiliton që e organizon këtë procesë.

Nga të gjithë anëtarët prezent me 7 votë pro, 2 anëtar nuk kanë marr pjesë në votim, i rekomandohet kuvendit për shqyrtim propozimet e komisionit për tituj nderi, dekorata, mirënjohje dhe falënderime për vitin 2024.

11.Pyetjet dhe propozimet lidhur me punën e Komunës, të ngritura nga anëtarët, ne atë rënditje siç janë pranuar:

Znj.Xhevahire Çeku Kelmendi: pasi që pika e 3-të ke për binjakzimin me komunën e Ulqinit radifikimin i marrveshjes, nëse më lejohet pak me përmirësu është familjarizimi që na e kemi aty është cekur viti 1999, unë mendoj që kemi raporte më të hershme se ky vit, po ashtu te binjakëzimi meqenëse po nevojitet vota e asambleistëve nuk kish me qenë keq që edhe ne asambleistat me qenë pjesë të komisionit dhe vizitave.

Pjesë e këtij procesverbali është edhe audio incizimi i këtij takimi të Komitetit për Politikë dhe Financa.

Meqë u shqyrtuan të gjitha pikat e rendit të ditës e propozime të tjera nuk pat, kryesuesi z. Rexhep Kurtbogaj e shpalli të mbyllur këtë takim të KPF-së në orën 11:45 h.

Procesmbajtësja,
znj. Donjeta Morina



